


THERMO + SWISS SHA

Permbledhje jo teknike per:

Aktiviteti: “ Prodhimi i produkteve prej plastike” te

Subjektit THERMO + SWISS sha



Aktiviteti: Prodhimi i produkteve prej plastike

Subjekti : THERMO + SWISS sha

Vendndodhja: Durres Xhafzotaj, Pasuria Nr. 14/119, Vol. 23, Faqe 74,
Zonë kadastrale 3852.

Pergatitur nga A Consultant sh.p.k, Korrik 2021

Me respekt

**Oliverta Dika
Administratore**



THERMO + SWISS SHA

Permbajtja

1. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI.....	4
a. Hyrje.....	4
a. Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese.	7
b. Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.	9
2. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;	10
a. Uji, akuiferet.....	10
b. Relievi dhe klima.....	10
3. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR; ...	13
a. Ndikime ne biodeversitet	13
b. Ndikime ne toke.....	13
c. Ndikime ne uje.	13
d. Ndikime ne ajer.	14
e. Fenomene te tjera.	14
4. NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, SI DHE PRODHIMIN E MBETJEVE	14
a. Shkarkimet te ujerave te ndotura.....	15
b. Shkarkimet ne ajer.	16
c. Zhurmat.	16
d. Gjenerimi i mbetjeve.	17
5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA;.....	18
6. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË;.....	18
7. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;.....	19
8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;	20

THERMO + SWISS SHA

- Identifikimi i masave zbutese.....	20
d. Permbledhja e masave zbutese	20
e. Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.....	27
9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË);.....	28
10. SIGURIA DHE SHENDETI NE PUNE DHE PERGJEGJSHMERIA SOCIALE E KOMPANISE.....	28
11. KONKLUZIONE	29

THERMO + SWISS SHA

1. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI

a. Hyrje

Subjekti Thermo + Swiss sh.a është regjistruar pranë QKB-se me datë 23/02/2015, me numër Nipt. L51423049P. Aktiviteti kryesor i subjektit është Import, eksport, tregtim llaçrash, përgatitje tullash, pajisje hidrosanitare, inerte, etj. Prodhime polisteroli dhe punime të ndryshme që lidhen me to. Prodhime llaçrash të gatshme, të thatë, të parapërgatitura për ndërtim dhe rrugë, në thasë dhe rifuxho, me bazë çimento, allçie, bitumi, koll, llaç, fino, bojak, stuko, bojra sintetike e natyrale me bazë pigmentesh hekuri dhe atyre organike, prodhime me bazë silikatesh dhe përgatitje tullash, inerte të granulometrisë. Punime të ndryshme të të gjitha këtyre materialeve. Import-eksport i të gjitha këtyre. Përshkrimi i objektit të shoqërisë ka natyrë indikuese dhe jo kufizuese. Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme. Shoqëria në çdo kohë mund të ripërcaktojë objektin e saj, ta shtojë apo pakësojë atë, me vendim të asamblesë së shoqërisë.

Thermo + Swiss sh.a kërkon që të pajiset me leje mjedisi Tipi B për aktivitetin "Prodhimi i produkteve plastike" me vendndodhje në Durres Xhafzotaj, Pasuria Nr. 14/119, Vol. 23, Faqe 74, Zonë kadastrale 3852.

THERMO + SWISS SHA

Ne figurat e meposhtme jepet vendndodhja e aktivitetit.



Figura 1. Pamja e larget e subjektit Thermo + Swiss sh.a



Figura 2 Pamja e afert e subjektit Thermo + Swiss sh.a

Subjekti per te ushtruar aktivitetin e tij ekonomik ka marre nje hapësire me qera (Kontrate qeraje dt.06.03.2017, me nr.1677, Rep. Nr 776 Kol.) e cila perbehet nga nje kapanon 1 kat, zyra 2 kate dhe rrethimi perreth dhe me vendndodhje ne Durres Xhafzotaj, Pasuria Nr. 14/119, Vol. 23, Faqe 74, Zonë kadastrale 3852.

Per ushtrimin e aktivitetit te tij subjekti ka siperfaqe totale prej 8744 m² nga keto ndertese eshte 7284 m² (kapanon 1 kat dhe zyra ne dy kate).

Adresa: Durres Xhafzotaj, Pasuria Nr. 14/119, Vol. 23, Faqe 74, Zonë kadastrale 3852.

THERMO + SWISS SHA

Planimetria e pergjithshme ku do te ushtrohet aktiviteti.




Figura 3. Panimetri e pergjithshme e kaponit

Tabela nr. 1 Koordinatat e vendndodhjes se Aktivitetit

Pika	x	y
1	4375642.82	4580371.42
2	4375626.96	4580395.58
3	4375734.33	4580418.43
4	4375738.61	4580396.75

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) është hartuar bazuar ne udhezimet dhe legjislacionin ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit ne pergjithesi dhe ne vecanti per ate te vleresimit te ndikimit ne mjedis. Raporti i VNM-se eshte pergatitur per te identifikuar ndikimet e mundshme qe mund te rezultojne nga funksionimi i aktivitetit “Prodhimi i produkteve prej plastike”. Ky raport i VNM-se eshte porositur nga subjekti THERMO + SWISS sh.a, nipt. L51423049P, me vendndodhje Durres Xhafzotaj, Pasuria Nr.14/119, Vol. 23, Faqe 74, Zonë kadastrale 3852.

Pergatitja e raportit te VNM-se u realizua duke u bazuar nga marrja e informacionit paresor nepermjet vizitave ne zonen ku do te zhvillohet aktiviteti ekonomik dhe nepermjet konsultimit te materialeve te publikuara ne kete fushe dhe te dhenave te tjera nga autoritetet shteterore dhe paleve te tjera te interesuara.

THERMO + SWISS SHA

a. Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese.

Zona ku ushtron aktivitetin kompania, është tokë e zhveshur nga bimesia dhe kryesisht e mbuluar me barishte, me një peisazh të zakonshëm dhe nuk gëzon ndonjë status të veçantë mbrojtjeje përveçse i përket florës, faunës dhe habitateve të ndryshme. Ky vend është i njohur si një zonë industriale ku përreth subjektit ushtrojnë aktivitetet e tyre ekonomike dhe subjekte të tjera.

Flora dhe fauna

Pozita gjeografike, ndërtimi gjeologjik, kushtet klimatike, pasuria ujore dhe lloji i tokave të territoreve të Durrësit kanë krijuar habitate të përshtatshme për botën e gjallë bimëre e shtazore. Tërësia e llojeve të qënieve të gjalla që jetojnë në këto territore përbën biodiversitetin e Durrësit dhe të Maminasit. Pozicioni gjeografik dhe veçoritë e kushteve natyrore i pozicionojnë territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Maminasit në rajonin e tipit Mesdhetar. Ky pozicionim është përcaktuar sipas klasifikimit paleartik të habitateve. Më poshtë janë evidentuar të gjitha bimët dhe kafshët e njohura të sipërfaqeve tokësore dhe hapësirave ujore, të territorit bashkiak të Durrësit.

Nga pikëpamja floristike, rrethi i Durrësit bën pjesë në zonën e shkurreve mesdhetare, të përfaqësuara nga dafina, mareja, shqopa dhe nga shkurret e tjera në formën e kacubeve të veçanta. Pranë bregut të detit shtrihet një brez gjelbërimi me pisha të zhvilluara mirë që janë me moshe 80 vjeçare që përveç pishesse bute gjendet dhe pisha e egër me moshe dhe llojet e tjera bimesie shoqeruese të egra si mersina, shqopa, etj.

Gjatë bregdetit gjendet një bazë pyjore natyre prej dushku dhe shelgu me moshe 60-80 vjeçare, i alternuar me pyll artificial prej pishash e plepash me moshe 20 vjeçare. Kushtet klimatike të zonës lejojnë të zhvillohet një bimësi e shumëllojshme që nga pishat, plepi, frasheri i zi, morina, palma dhe dafina, deri në bimët e tjera dekorative si: frasheri gjethengushtë, vërria, eukalpti, shelgu lotues, etj.

Kur temperatura mesatar është mbi 10°C periudha e vegjetacionit fillon në ditët e para të marsit dhe përfundon në ditët e para të dhjetorit. Të ruajtura në forme natyrore shumica e drurëve të lartpërmendur gjenden në territorin e gjere të rajonit të Durrësit që përben një zonë me karakterin e një parku natyror të këndshëm.

THERMO + SWISS SHA

Në zonat me te larta te rrethit (p. sh. zona e Ishmit) rriten shkurre që i rrezojnë gjethet e tyre gjate stines se dimrit si: shkoza, murrizi, driza, etj. Në Xhafzotaj, Sukth, Gjipale, Spitall etj, rriten edhe bime te ulëta si: mullaga, hithra, lulekuqa, tatulla, kopra e egër, ndërsa gjethe delli, lulebasami, hithra, grami, rrodhja, netulla, bar pate rriten kryesisht në zonën e Shijakut, Maminasit, Katundi te Ri dhe Ishmit.

Përveç bimësisë pyjore që zë vend te rëndësishëm në bimësinë e rrethit, po kaq rëndësi kane edhe kulturat buqesore te përfaqësuar nga: gruri, misri, fasulja, ulliri, lule dielli, te cilat përhapjen me te madhe e kane në zonën e Shijakut, Maminasit, Spitalles, Sukthi. Pothuajse në te gjithë rrethin kultivohen perime si: speci, domatja, kastravec, bizelja, etj., dhe agrumet (portokalli, limoni) te cilat prodhohen me shume pergjate bregdetit.

Bota shtazore e Durrësit është e shumëllojshme, në varësi edhe të tërësisë së habitateve tokësore e ujore që gjenden në këto territore. Në grupin e faunës tokësore bëjnë pjesë gjitarët e tokës (mishngrënës dhe barngrënës), shpezët, zvarranikët, amfibët, insektet etj. Të gjitha kafshët tokësore të hapësirës territoriale të Durrësit, janë pothuajse të ngjashëm me ato të të gjithë Shqipërisë dhe mbarë Mesdheut. Zona e Durrësit eshte e pasur me lloje të shumta shpezësh të tokës dhe ujit, sedentarë dhe shtegtarë. Një pjesë e madhe e shpezëve banojnë në këto territore në mënyrë të përhershme e si të tillë, ata janë sedentarë. Por ka edhe një numër të madh shpendësh, të quajtur shtegtarë, që vijnë nga viset e Europës Veriore për të kaluar dimrin në këto territore. Disa të tjerë e kalojnë tek ne muajin e verës, ndërsa në dimër zbresin në viset më të ngrohta të Afrikës Veriore dhe Qëndrore. Kemi dy grupe shpendësh, ato që shtegëtojnë në distanca të vogla dhe në distanca të mëdha (shtegëtime ndërkontinentale). Shpendët që vijnë për të dimëruar në territoret e këtyre bashkive janë tushat, laureshat etj; nga rendi i harabelave (Passeriformes); rosat e patat nga rendi i patorëve Anseriformes); disa shpendë nga rendi i pëllumbave të egër (Colmbiformes); nga rendi shapkave dhe i gjelzave të ujit (Charadruiformes) etj. Nga shpezët e grupit të dytë mund të përmendim disa lloje nga rendi i harabelorve, sic janë bilbilat (*Lucinia megarhyncha*), bilbilthat (gjinia *Sylyvia*), bishtatundësit (gjinia *Motacilla*), dallëndyshet, bengat etj., ndërsa nga rendet e tjera shkurtat, turtujt etj. Pjesa më e madhe e shpezëve sedentarë i ndërtojnë foletë e tyre atje ku dimërojnë,

THERMO + SWISS SHA

por ka edhe shumë prej tyre që bëjnë migracione sezonale, kryesisht vertikale brenda vendit. Interesantë janë edhe migracionet ditore të shumë shpendëve, të cilët lidhen kryesisht me sigurimin e ushqimit. Krahas shpezëve të tokës, kemi edhe shpezët e ujit, që gjenden në ujërat bregdetare. Ato janë të familjes së rosave, patave (Anatidae), të shapkave (Scrolopacidae) etj. Në grupin e shpezëve të tokës bëjnë pjesë: Thëllëza e fushës (*Perdix perdix*, L), Shkurta (*Coturnix coturnix* L) etj. Bota e zvarranikëve është mjaft e pasur me lloje dhe ekzemplarë. Midis zvarranikëve të tokës përhapje më të madhe kanë breshkat, gjarpërinjtë dhe hardhucat. Breshkat e tokës përfaqësohen nga breshkat e zakonshme (*Testudo hermanni* Gmel.). Gjarpërinjtë janë më të shumtë e më të shumëllojtë. Përhapje të gjërë kanë ata johelmues si: Shigjetat (*Coluber gemonensis*, C. *Najadum* e C. *Jugularis*) dhe disa bolla, si bolla e shtëpisë (*Elaphe longissima*) dhe bolla me katër vija (*Elaphe quatuorlineata*). Nga gjarpërinjtë helmues më i rrezikshmi është nepërka e zakonshme (*Vipera ammodytes*). Hardhucat, më e përhapur është hardhuca e mureve (*Lacesta muralis*) dhe zhapiku i gjelbër *Lacesta viridis*, L), që banon në vende të mbuluara me shkurre e ferra.

Zona ku do vendoset aktiviteti është ndertese dhe nuk ka asnje lloje faune edhe flore ne te.

b. Tokat, kategoria e tokës, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.

Territoret e bashkisë së Durrësit përfshihen në Përkuljen Pranadriatike.

Karakteristike janë depozitimet terrigjene, të periudhës neogjenike dhe depozitimet aluvionale, detare dhe lagunore-kënetore të periudhës kuaternare. Shkëmbinjtë terrigjenë përfaqësohen nga molasat neogjenike, të moshës tortoniane, mesiniane dhe suitës Helmesi të pliocenit. I rëndësishëm është trajtimi i tyre sipas periudhave gjeologjike.

THERMO + SWISS SHA

2. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;

a. Uji, akuiferet

Territoret e bashkisë së Durrësit bëjnë pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumenjve Erzen, Ishëm dhe në pellgun ujëmbledhës të detit Adriatik. Kurrizi kodrinor Rodon-Erzen shërben si kufi ndarës i pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve të mësipërm. Pjesë të caktuara të fushës së Durrësit, të cilat kanë pjerrësi të vogël nga niveli i detit, i derdhin ujërat direkt në detin Adriatik. Rrjeti hidrografik sipërfaqësor përfaqësohet nga deti Adriatik, lumenjtë (Erzen dhe Ishëm), përrenjtë, prroskat, liqenet bregdetare dhe objektet ujore artificiale si: ujëmbledhësit dhe kanalet kullues të ndërtuar mbas vitit 1950. Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Maminasit kanë shtrirje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore. Ujërat nëntokësore gjenden shumë pranë sipërfaqes së tokës. Cilësia e ujërave nëntokësore nuk është e mirë për të furnizuar banorët me ujë të pijshëm. Ujërat nëntokësore kanë përmbajtje të lartë të kriprave dhe kjo lidhet edhe me përzierjen e ujërave nëntokësore me ujërat detare, si rezultat i afërsisë së tyre.

Ushtrimi i aktivitetit nuk ndikon në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore të zones.

Në zonen ku është ndërtuar objekti ku do vendoset fabrika në veriperendim gjendet rezervuari i Rubjekes dhe në jug-lindje gjenden rezervuarët e Karpen dhe Metalles. Këto trupa ujor nuk nderveprojnë me objektin në fjalë. Në afërsi të ndertesës kalon një proçke që fillon në Vlorë dhe shërben si kanal kullues dhe mbledhës i gjithë urave të zones ndërmjet Vores dhe Maminasit dhe ecën në drejtim të Hamallajt duke u bashkuar me kanalet kullues të fushës së Durrësit. Në këtë proçke pritet të shkarkohen ujërat e përdorura që do të dalin nga impjanti i trajtimit të ujërave të përdorura.

b. Relievi dhe klima

Relievi i territorit të bashkisë së Durrësit konsiderohet fushorokodrinor. Fushat zënë 67% të sipërfaqes, ndërsa kodrat 33% të tyre. Territori fushor zënë pjesën qendrore, ndërsa territoret kodrinore gjenden në periferi të bashkive, sidomos në pjesën veriore,

THERMO + SWISS SHA

lindore dhe atë perëndimore. Lartësia maksimale mbi nivelin e detit është 269 m (afër fshatit Kuratni, bashkia Durrës). Nuk mungojnë as kriptodepresionet (2 m) në veri të fushës së Durrësit (bashkia Durrës). Lartësia mesatare është 135 m. Në tabelën e mëposhtme paraqitet lartësia hipsometrike e territoreve të Durrësit dhe të Shijakut. Relievi fushoro-kodrinor i këtyre bashkive është krijuar në kushtet e tekrorogjenezën alpine dhe nën ndikimin e faktorëve të jashtëm. Si modelues kryesor të këtij relievi evidentojmë veprimtarinë detare dhe lumore. Mbi këtë bazë evidentojmë tipin gjenetike të relievit strukturor, lumor, bregdetar dhe erozivo-denudues.

Territoret e bashkisë së Durrësit si pjesë territoriale e Shqipërisë, bëjnë pjesë në gjerësitë gjeografike mesatare. Dalja e gjerë në detin Adriatik, si pjesa më veriore e detit Mesdhe, i jep klimës tipare mesdhetare. Tipari dallues i klimës mesdhetare është ekzistenca e katër stinëve (pranvera, vera, vjeshta dhe dimri). Në formimin e klimës së vendit tonë në tërësi dhe klimës tipike në hapësirën territoriale të Durrësit e të Shijakut kanë ndikuar rrezatimi diellor, qarkullimi i masave ajrore të përgjithshme dhe faktorët lokal. Ndikim dominues në formimin e klimës e ka energjia diellore e drejtpërdrejtë, deti Adriatik dhe relievi fushoro-kodrinor. Një ndikim më të vogël ushtrojnë masat qarkulluese të ajrit, lloji i tokave, mbulesa bimore dhe veprimtaria e njeriut në këto territore. Sipas zonalitetit klimatik të përcaktuar për vendin tonë, territoret e bashkisë së Durrësit bëjnë pjesë në zonën e klimës mesdhetare fushore, nënzona qëndrore. Kjo konsiderohet si një zonë që merr sasi të mëdha të rrezatimit diellor. Sipas të dhënave nga Instituti Meteorologjik Shqiptar, kjo hapësirë territoriale merr rreth 192.3 kkal/ cm² gjatë një viti kalendarik, në kushtet e motit pa vranësira. Rëndësi ka jo vetëm sasia e madhe e energjisë diellore por edhe shpërndarja gjithëvjete pothuajse e njëjtë e saj. Numri i diteve me diell është 340 dite. Vlerat më të mëdha të këtij rrezatimi i kanë muajt korrik dhe gusht me 324 orë në të 31 ditët e tyre, kurse vlerat më të vogla muajt dhjetor dhe janar 105-116 orë në 22-25 ditë 35 . Rrezatimi diellor i ndikuar dhe nga faktorët lokal ka përcaktuar këto tipare të temperaturave të ajrit. Temperatura mesatare vjetore është 16°C. Muaji më i ngrohtë është korriku me temperaturë mesatare 23.8 °C. Dimri është i butë me ndikim të fortë detar. Temperatura mesatare e janarit lëkundet nga 7,5-8.2°C. Minimumet absolute zbresin deri në -6°C dhe -7°C. Temperatura maksimale absolute e regjistruar ka arritur

THERMO + SWISS SHA

në 39.0°C regjistruar në 14 gusht 1957, ndërsa minimumi absolut -6.2°C regjistruar në 26 janar 1954 në qytetin e Durrësit³⁶. Temperaturat më të mëdha se 20°C zgjasin 150-160 ditë në vit dhe vendosen pothuajse në mënyrë të qëndrueshme nga muaji maj deri në 10-ditëshin e parë të tetorit. Periudha me ngrica është e shkurtër. Numri i ditëve të akullta është i kufizuar. Zakonisht vrojtohen 15-30 ditë në vit, gjatë të cilave temperatura minimale zbret nën 0°C ose është 0°C. Ditët e akullta duken nga fundi i nëntorit deri nga fundi i 10-të ditësisht të parë të marsit. Por përgjithësisht ato janë të përqëndruara gjatë janarit dhe shkurtit 37. Periudha e vegjetacionit (temperaturat mesatare mbi 10 °C) fillon mesatarisht në fillim të marsit dhe vazhdon deri në fillim të dhjetorit. Afërsia e zonës me detin bën që në pranverë ngrohja të jetë e ngadaltë. Tipari dallues i kësaj nënzone klimatike është dimri i butë dhe i lagësht dhe vera e nxehtë dhe e thatë.

Tabela 1. Te dhenat per klimen ne Durres.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Temperatura mesatare(°C)	8.1	9	10.9	14	18.1	21.8	23.8	23.9	21.2	17.2	13	9.9
Temperatura minimale (°C)	4.8	5.6	6.9	9.7	13.6	17.2	19	19	16.5	13	9.5	6.5
Temperatur maksimale (°C)	11.4	12.5	14.9	18.3	22.6	26.5	28.7	28.8	26	21.4	16.6	13.3
Temperatura mesatare(°F)	46.6	48.2	51.6	57.2	64.6	71.2	74.8	75.0	70.2	63.0	55.4	49.8
Temperatura minimale (°F)	40.6	42.1	44.4	49.5	56.5	63.0	66.2	66.2	61.7	55.4	49.1	43.7
Temperatura maksimale (°F)	52.5	54.5	58.8	64.9	72.7	79.7	83.7	83.8	78.8	70.5	61.9	55.9
Rreshje / Shi (mm)	132	107	99	81	68	41	26	36	71	112	160	131

THERMO + SWISS SHA

3. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR;

Nga aktiviteti i propozuar pritet te kete ndikime ne aspekte te ndryshme te mjedisit dhe zones ne fjale. Shkalla dhe perhapja e tyre do te pershkruset me poshte.

a. Ndikime ne biodeversitet

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk pritet te kete ndikime te qenesishme ne biodivetsitetin e zones. Siperfaqja qe do te zihet eshte brenda territorit per te cilin subjekti e zoteron nje leje mjedisi. Siperfaqja qe do te perdoret nga subjekti nuk ka patur ndonje bimesi me vlera te vecanta per biodiversitetin. Gjate fazes se ndertimit dhe funksionimit te aktivitetit do te sigurohet rrethimi i territorit te subjektit. Gjate funksionimit do te merren masa te forta qe te mos kete mundesi te futen shpend te egra te cilat mund te sillnin per shpendet ose do te merrni semundje nga shpendet. Te gjitha dritare e ajerimit dhe te ventimilimti si dhe tubacionet e mundeshme qe jane ne komplekse te jen e te pajisjura me rrjeta te imta per te mos lejuar hyrjen e shpendeve te egra.

b. Ndikime ne toke.

Ndikimi me i madh ne toke i ketij projekti eshte gjate fazes se ndertimit te objektit duke shkaktuar zenie te siperfaqes se tokes nga ndertimi i dy mjediseve qe do te funksionojne pre te njejtin aktivitetit. Ushtrimi i ketij aktiviteti nuk gjeneron mbetje teknologjike te demshme qe mund te ndikojne ne cilesine e tokes. Mund te krijohen mbetje nga materialet e ndertimit inertet do te perdoren ne vend per shtrim territori. Mbetjet metalike qe mund te dalin do te perdoren gjate procesit ose do te largohen nga subjekti qe i gjeneron ato. Do te krijohen mbetjet e ngjashme me mbetjet urbane, te cilat do te mbahen ne kosha te posacem dhe rregullisht do te boshatisen e dergohen ne vend depozitimin e percaktuar nga pushteti vendor.

c. Ndikime ne uje.

Gjate fazes se ndertimit nuk pritet te kete shkarkime ne uje nga aktiviteti i ndertimit, sepse proceset ndertimore jane shume te thjeshta dhe nuk parashikojne perdorim te

THERMO + SWISS SHA

ujit dhe shkarkime te ujerave te ndotura. Kujdes do te tregohet me materialet e ndertimit qe te mos shpelahen ose ndosin ujerat nentokesore. Cdo material do te ruhet dhe magazinohet ne masa te rrepta. Gjithe periudhes se ushtrimit te aktivitetit nuk do te kete shkarkime te lendeve ndotese ne uje. Proceset teknologjike te ketij aktiviteti perdorin ujin por nuk pritet te kete shkarkime te lengeta te rrezikshme industriale, pasi uji do te riperdoret nepermjet qarkullimit te brendshem. Gjate aktivitetit uji perdoret per bumimin e lendes se pare dhe eshte pa humbje, pjesa tjeter e ujit perdoret qellime higjenike dhe per higjiene dhe wc te punonjesve. Subjekti do te marre masa qe i gjithe territori i subjekti te jet i shtruar me cemento te papershkueshme nga ujerat si dhe do te ngrihet nje sistem i mbyllur per grumbullimin e ujerave te reshjeve qe mund te grumbullohen ne territorin e aktivitetit. Te gjitha keto masa synojne qe te mos ndodhin aksidente per ndotjen e ujerave siperfaqesore apo atyre nentokesore.

d. Ndikime ne ajer.

Gjate fazes se ndertimit nuk pritet te kete ndikime te qenesishme ne ajer. Shkarkimet kryesore jane pluhur nga shkarkimi i materialeve te ndertimit ne terren, si dhe gazet e diegies (NOx, SO2, CO2) nga mjetet e sjelljes se materialeve inerte te betonit. Gjate aktivitetit shkarkimet kryesore ne ajer do te jene shkarkimet e nga oxhaku nga kaldaja.

e. Fenomene te tjera.

Vibracioni, nxehtesia, radiacioni, ndricimi verbues etj, nuk jane te pranishem gjate zhvillimit te ketij aktiviteti. Nuk aplikohet.

4. NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, SI DHE PRODHIMIN E MBETJEVE

THERMO + SWISS SHA

a. Shkarkimet te ujerave te ndotura.

Gjate fazes se ndertimit nuk pritet te kete shkarkime ne uje nga aktiviteti i ndertimit, sepse proceset ndertimore jane shume te thjeshta dhe nuk parashikojne perdorim te ujit dhe shkarkime te ujerave te ndotura. Kujdes do te tregohet me materialet e ndertimit qe te mos shpelahen ose ndosin ujerat nentokesore. Cdo mateirila do te ruhet dhe magazinohet ne masa te rrepta. Gjithe periudhes se ushtrimit te aktivitetit nuk do te kete shkarkime te lendeve ndotese ne uje. Proceset teknologjike te ketij aktiviteti nuk perdorin ujin apo shkaktojne shkarkime te lengeta te rrezikshme industriale. Gjate aktivitetit uji perdoret per bymimin e lendes se pare si dhe ri qarkullohet ne sistem, pjesa tjeter e ujit perdoret qellime higjenike te brendshme per higjienen e punonjesve. Subjekti do te marre masa qe i gjithe teritori i subjekti te jete i shtruar me cemento te papershkueshme nga ujerat si dhe do te ngrihet nje sistem i mbyllur per grumbullimin e ujerave te reshjeve qe mund te grumbullohen ne territorin e aktivitetit. Te gjitha keto masa synojne qe te mos ndohdin aksidente per ndotjen e ujerave siperfaqesore apo atyre nentokesore.

Tabela nr.6 Evidentimi i ujerave te ndotura

Pyetje	PO	JO	Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime te ujerave te ndotura?		Jo	
A ka ujera te ndotura me natyre toksike?		X	
A behen shkarkime ne rrjetin e kanalizimeve?		X	Per tualet dhe higjene personale te punonjesve do te kete shkarkohen ne rrjetin ekzitues te komunes Xhafzotaj
A behen shkarkime ne siperfaqet ujore?	Po		Ujerat e pastrimit te territorit te subjektit.
Jepni sasine e ujerave te ndotura (m ³ / dite)		X	2 m ³ ne dite per qellime higjene dhe perdorimin e tualeteve.

THERMO + SWISS SHA

b. Shkarkimet ne ajer.

Gjate fazes se ndertimit nuk pritet te kete ndikime te qenesishme ne ajer. Shkarkimet kryesore jane pluhur nga shkarkimi i materialeve te ndertimit ne terren, si dhe gazet e diegies (NOx, SO2, CO2) nga mjetet e sjelljes se materialeve inerte te betonit.

Gjate aktivitetit ekonomik shkarkimet kryesore ne ajer do te jene shkarkimet nga oxhaku nepermjet funksionimit te kaldajes.

Tabela nr.7 Evidentimi i shkarkimeve ne ajer

Pyetje	PO	JO	Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime ne ajer (nga oxhaqet) ?	Po		Gaze te diegies (NOx, SO2, CO2) qe clirohen nga diegia e gazit ne kaldaje qe perdoret per ngrohjen e ujit per te formuar lenden e pare,
A ka shkarkime nga burime te shperndara?	Po		Gaze te diegies (NOx, SO2, CO2) qe clirohen nga automjetet
A ka erera te keqija?		Jo	

c. Zhurmat.

Gjate ndertimit pritet kete zhurma te nivelit te nje aktiviteti industrial nga mjetet e punes dhe te transportit te materialeve per ndertimi. Gjate aktivitetit nuk do te krijohen zhurma shqetesuese pertej normave te lejuara per ambientet e punes, te cilat mund te ndikojne per punonjesit e punesuar dhe mjedisin perreth.

Tabela 8. Zhurmat gjate aktivitetit

Pyetje	PO	JO	Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin)

THERMO + SWISS SHA

A gjenerohen zhurma?	Po		Zhurmat do te vijne nga linjat e prodhimit te produkteve prej plastike
A gjenerohen vibracione?		Jo	

d. Gjenerimi i mbetjeve.

Ushtrimi i ketij aktiviteti nuk gjeneron mbetje teknologjike te demshme qe mund te ndikojne ne cilesine e tokes. Mund te krijohen mbetje nga materialet e ndertimit inertet do te perdoren ne vend per shtrim territori. Mbetjet qe mund te dalin do te perdoren gjate procesit ose do te largohen nga subjekti qe i gjeneron ato. Do te krijohen mbetjet e ngjashme me mbetjet urbane, te cilat do te mbahen ne kosha te posacem dhe rregullisht do te boshatisen e dergohen ne vend depozitimin e percaktuar nga pushteti vendor. Nje liste e mbetjeve te mundshme qe gjenerohen jepen ne tabelen e meposhtme.

THERMO + SWISS SHA

Tabela 9. Mbetjet e ngurta

Pyetje	PO	JO	Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen mbetje te ngurta?	Po		Mbetjet nga prerjet e polisterolit (riciklohen brenda territorit te subjektit dhe rifuten ne sistem) 20 kg/dite mbetje te ambllazhit plastik rreth 15 kg/muaj mbetje te ngjashme me ato urbane 3.5 kg/dite
A gjenerohen mbetje te ngurta te rrezikshme?		Jo	
Te asgjesuara ne territorin e impiant/instali mit?	Po		Mbetjet nga prerjet e polisterolit (riciklohen brenda territorit te subjektit dhe rifuten ne sistem) 20 kg/dite

5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA;

Pergatitja e terrenit, rrethimi dhe kryerja e punimeve per ndertimin do te zgjas rreth 2 muaj. Keshtu qe ndikimet ne uje, ajer, toke do te zgjasin deri ne 2 muaj.

Funksionimi i aktiviteti eshte me kohe te pacaktuar dhe ndikimet e identifikaura do te zgjasin gjate gjithë kohes se funksionimit. Ne cdo rast ndikimet e identifikuara do te zgjasin per aq kohe sa do te zhvillohet ky aktivitet. Me perfundimin e ketij aktiviteti nuk do te kete ndikime. Ndikimet e identifikuara qe mund te ndodhin gjate punimeve dhe gjate funksionimit do te adresohen nga subjekti nepermjet marrjes se masave zbutese si dhe nepermjet programit dhe sistemit te manaxhimit mjedisor.

6. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA

THERMO + SWISS SHA

VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË;

Ndikimet e mundshme që mund të rezultojnë nga ky aktivitet janë të karakterit lokal dhe nuk shtrihen në zona të tjera përreth aktivitetit. Nga funksionimi i aktivitetit nuk pritet të ketë ndikime të qenesishme që mund të perhapen në kohë dhe në hapësirë në zonën e projektit apo më gjere. Zhvillimi i aktivitetit nuk sjell ndikime të mundshme hapësimore, të cilat mund të nënkuptohen në distancën fizike nga vendndodhja e projektit.

7. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;

Meqenëse i gjithë aktiviteti do të zhvillohet në brendësi dhe sipërfaqe aktuale të pronës që disponon subjekti, në përfundim të funksionimit të këtij aktiviteti për të rehabilituar këto sipërfaqe subjekti do të kryej:

- largimin e makinerive dhe pajisjeve;
- largimin e çdo mbetje dhe materiali;
- largimin e platformave prej betoni apo çdo materiali tjetër, mbetje ndërtimi apo hekuri nga vendet ku ka patur ndërhyrje në objekt;
- kthimin e objektit në gjendjen përpara fillimit të aktivitetit.

Në varesi të destinacionit të funksionit të ardhëm të këtij objekti, subjekti do të kryej ndryshimet dhe modifikimet e duhura të objektit.

Në rast se do të priset objekti ose do të bëhet i përdorshëm subjekti duhet ta kthejë territorin në përputhje me natyrën e zonës përreth ose në gjendjen e mëparshme. Në këto rast një ndër masat kryesore të rehabilitimit mjedisor është mbjellja e barit ose pyllëzimet. Mbjellja e barit është një aktivitet i thjeshtë ndërsa mbjellja e bimëve dhe pyllëzimi ka nevojë për vendosje kriteresh dhe përcaktim të llojeve që do përdoren për

THERMO + SWISS SHA

pyllezim. Nje permbledhje e kostove te pergjithseshme te kthimit te teritorit ne gjendjen e meparshme jepet ne tablene e meposhteme:

Tabela 4. Kosto te detajuar te mbjelljes se bimeve

Nr.	Procesi i punes	Vlefta
1	Largim pajisjes dhe makinerish te linjes se pularise	500,000
2	Largim lendesh te para dhe produkte	200,000
3	Largim platformash, mbetjesh, te impjantit, etj	300,000
4	Prishje e objektit	200,000
5	Largim mbetjesh te objektit	100,000
6	Mbjellje bari dhe pyllezim per ha	277,739
7	Shuma totale	1,577,739

8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;

Per minimizimin e ndikimeve ne mjedis gjate fazes se funksionimit kompania ka pergatitur dhe do te implementoj Planin e Menaxhimit Mjedisor (PMM). Te gjitha aktiviteti do te realizohen ne perputhje me kete plan.

- Identifikimi i masave zbutese.

Nga ushtrimi i aktivitetit kemi identifikuar ndikime ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe te funksionimit te aktiviteti. Jane identifikuar masat zbutese te propozuara per tu ndjekur nga kompania, qe jepen te permbledhura.

d. Permbledhja e masave zbutese

Zhvillimi i aktivitetit pritet te kete ndikime ne mjedis si cdo aktivitet tjeter gjate fazes se ndertimit dhe instalimit si dhe funksionimit te perhershem te tij.

Subjekti do te zbatoje politika dhe ngrrej sisteme te manaxhimit te mjedisit qe te evitojne ne vijimesi ndikimet e mundshme ne mjedis dhe do te marre masa per zbutjen e tyre ne perputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi dhe kushtet e Lejes Mjedisore. Nga ky aktivitet kemi ndikime kryesore ne prodhimin e zhurmave por jo ne vlera

THERMO + SWISS SHA

shqetesuese, per te cilat subjekti ka marre dhe do te marre masa ne vazhdimesi per menjanimin dhe zbutjen e tyre. Ne tabelen e meposhtme jepet nje permbledhje e ndikimeve ne mjedis dhe masat zbutese te propozuara.

THERMO + SWISS SHA

Tabela 5. Permbledhje e ndikimeve dhe masave zbutese

Nr	Faza	Ndikimi	Masa zbutese te propozuara	Ndikimi qe ngelet	Kostot e masave	Pergjegjesia
1	Ndertimit	Ndikimi ne peisazh Ndertesa ku zhvillohet aktiviteti do te ndertohet dhe nuk paraqet ndikim shtese.	Lartesi a ndertese nuk do te kaloj 4 m qe eshte mesatarja e ndertesave ne zone	Jo domethenes	Perfshihet ne kostot e funksionimit	THERMO + SWISS sha
2	Ndertimit	Zhurma Zhurmat qe do te gjeneroje automjetet dhe makinerite e punes nuk jane ne nivele te larta dhe domethenese per zonen perreth.	Do te punohet vetem gjate oreve te punes 08:00-16:00; Do te lejohen ne kantjer vetem automjete dhe mjete qe nuk kalojne nivelet e zhurmave; Punonjesit do te instruktohen dhe pajisjen me mjete te mbrojtjes personale	Jo domethenes	Perfshihet ne kostot e funksionimit	THERMO + SWISS sha
3	Ndertimit	Cilesia e ujerave siperfaqesore dhe nentokesore; Nuk ka shkarkime te ujerave te ndotur ose teknologjike. Do te kete vetem wc per punjesit	Do shkarkohen ne kolektorin kryesore te komunes Xhafzotaj	Jo domethenes	Perfshihet ne kostot e funksionimit	THERMO + SWISS sha
4	Ndertimit	Ndryshimi i habitateve. Zona eshte pa bimesi	NA	Jo domethenes	Nuk aplikohet	THERMO + SWISS sha

THERMO + SWISS SHA

		te lart, ka vetem bime barishtore. Nga ky aktivitet nuk parashikohen te kete ndikime ne ndryshimin e habitateve.				
5	Ndertimit	Mbetjet Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jane pak mbetje te materialeve te ndertimit, si dhe ato te ngjashme me ato urbane.	Keto mbetje do te depozitohen rregullisht ne kazanet e percaktuara nga Pushteti Vendor. Monitorohet ne vijimesi	Jo domethenes	Kostoja e transportit dhe depozitimit. Perfshihet ne kostot e funksionimit	THERMO + SWISS sha
6	Ndertimit	Shendetit dhe siguria ne pune	Do te merren masat qe subjekti te rrethoj zone e ndertimit dhe do te zbatoj ne vijimesi rregullat e sigurise dhe shendetit ne pune, si dhe pajisjes se punonjesve dhe vizitoreve me uniformat dhe mjetet e nevojshme te mbrojtjes personale ne pune. Gjithandej ne vendet e punes do te vendosen tabela te sinjalizimit per kujdesin ne pune. Sipas rastit do ndertohen rrethimet dhe kufizimet e	Do monitorohet ne vijimesi	Kosto e parashikura ne kostot e funksionimit.	THERMO + SWISS sha

THERMO + SWISS SHA

			nevojshme per zonat ne rrezik.			
7	Ndertimit	Ajeri Mund te kete gaze te digies nga automjetet dhe nga kaldaja dhe pluhur total nga materialet e ndertimit	Ne site do vijne mjete qe kane kaluar testin e diegies dhe te kualidimit vjetot	Do te monitorohen Pluherat dhe PM10 cdo tre muaj; Gazet e diegies cdo tre muaj	Kosto e parashikura ne kostot e funksionimit.	THERMO + SWISS sha
8	Funksionim	Ndikimi ne peisazh	Ndertesa ku do zhvillohet aktiviteti nuk do te kete lartesi me te larte se 3-4 m. Subjekti do te mjell peme ne periferi te aktivitetit	Jo domethenes	Perfshihet ne kostot e funksionimit	THERMO + SWISS sha
9	Funksionim	Zhurma Zhurmat kryesisht do te jene nga automjete qe vijne ne subject per te lene lendet e para dhe per te marre produktet si dhe nga sistemi I aspirimit.	Punonjesit do te instruktohen dhe pajisjen me mjete te mbrojtjes personale;	Jo domethenes	Perfshihet ne kostot e funksionimit	THERMO + SWISS sha
10	Funksionim	Cilesia e ujerave siperfaqesore dhe nentokesore	Nuk ka asnje ndikim negativ pasi shkojne ujerat e pastrimeve te jashtme te subjektit	Subjekti do te monitoroj cdo tre muaj parametra te tilla si pH, Lendet ne CE, BOD5, COD, Nitrati total, Fosfori total.	Perfshihet ne kostot e funksionimit	THERMO + SWISS sha
11	Funksionim	Ndryshimi i habitateve		Jo domethenes	Nuk aplikohet	THERMO + SWISS sha

THERMO + SWISS SHA

		Nga ky aktivitet nuk parashikohen te kete ndikime ne ndryshimin e habitateve.				
12	Funksionim	Mbetjet Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jane mbetjet nga prerjet e polisterolit (referuar madhesise se produktit), si dhe mbetje te ngjashme me ato urbane.	Mbetje te ngjashme me ato urbane do te depozitohen rregullisht ne kazanet e percaktuara nga Pushteti Vendor.	Pergatitet dhe zbatohet plan i manaxhimit te mbetjeve	Kostoja e transportit dhe depozitimit. Perfshihet ne kostot e funksionimit	THERMO + SWISS sha
13	Funksionim	Shendetit dhe siguria ne pune Ceshtje te lidhura me sigurine dhe shendetin mund te jene: Aksidente ne pune nga perdorimi i linjes se prodhimit ;	Do te vazhdohet te ndiqen te gjitha rregullat e sigurimit teknik ne pune si dhe pajisjes se punonjesve dhe vizitoreve me uniformat dhe mjetet e nevojshme te mbrojtjes personale ne pune. Gjithandej ne vendet e punes do te vendosen tabela te sinjalizimit per kujdesin ne pune. Sipas rastit do ndertoehen rrethimet dhe kufizimet e nevojshme per zonat ne rrezik.	Subjektit ka sistem per sigurine dhe shendetin ne pune	Kosto e parashikura ne kostot e funksionimit.	THERMO + SWISS sha

THERMO + SWISS SHA

14	Funksionim	Ajeri Do te realizohen monitorime jo te vazhduara ne vijimesi	Do te monitorohet subjekti	Do te monitorohen rregullisht: Pluherat dhe PM10 cdo 6 muaj; Gazet e diegies cdo 6 muaj	Kosto e parashikura ne kostot e funksionimit.	THERMO + SWISS sha
----	------------	--	-------------------------------	--	--	-----------------------

e. Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.

Realizimi i objektivave dhe i treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt varet nga respektimi i te gjithe treguesve te siperpermendur. Kontrolli i monitorimit dhe permiresimi i vazhdueshem i teknologjise se perdorur kushteve te punes dhe ambientit rrethues, do te coje ne mirefunksionimin e aktivitetit.

Tabela 6: program te monitorimit mjedisor dhe te sigurise dhe shendetit ne pune

Nr	Aspekti i monitoruar	Parametrat e monitoruar	Shpeshtia e monitorimit	Pergjegjes
1	Cilesi e ajerit te mjedisit dhe ne afersi te oxhakut	NOx, SOX, C6H6, PM ₁₀ , pluhur total	Cdo 6 muaj	THERMO + SWISS sha
2	Zhurmat ne mjedis dhe ne ambjentet e punes	Zhurma	Cdo 6muaj	THERMO + SWISS sha
3	Shkarkimet e ujerave te perdorura	pH, percueshmeri elektrike, BOD5, COD, N total, Fosfori total	Cdo 6 muaj	THERMO + SWISS sha
4	Zbatimi i sistemeve te manaxhimit mjedisor dhe te sigurise dhe shendetit ne pune	Plotesimi i rekordeve, zbatimi i programeve dhe veprimeve permiresuese	Cdo 6 muaj	THERMO + SWISS sha

5	Trajtimi dhe largimi i mbetjeve	Pergatitet dhe zbatohet plani i manaxhimit te mbetjeve	Cdo dite	THERMO + SWISS sha
---	---------------------------------	--	----------	--------------------

9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË);

Subjekti ushtron aktivitetin ne Xhafzotaj, Durres nje zone lehtesishte e monitorueshme.

Ne afersi dhe perreth subjektit ka subjekte te cilet kryejne aktivitetin e tyre ne zone. Megjithate ndikimet e identifikuarra per kete aktivitet jane te natyres lokale dhe jo me perhapje apo shtrirje nderkufitare. Si perfundim ky projekt nuk parashikohet te kete ndikime ne mjedisin nderkufitar. Aktiviteti “ Prodhimi i produkteve prej plastike “ nuk eshte nje aktivitet me rrezikshmeri te larte te zjarrvenies.

10. SIGURIA DHE SHENDETI NE PUNE DHE PERGJEGJSHMERIA SOCIALE E KOMPANISE

Cdo aktivitet ekonomik shfaq rrishtun e ekspozimit te punonjesve ndaj rreziqeve, qe lidhen me manovrimin e makinerive dhe pajisjeve qe perdoren. Kompania Devis do te ngrej nje sistem per sigurine dhe shendetin ne pune dhe synon qe te marre te gjitha masat per ndergjegjesimin dhe trajnimin, sigurimin e pajisjeve mbrojtese personale si dhe ngritjes se procedurave perkatese per te shmangur aksidentet. Per evitimin e rreziqeve dhe aksidenteve te mundshme subjekti ka zbatuar ne vazhdimesi keto detyra kryesore:

- Personeli i punesuar eshte i pershtatshem per pozicionin e punes.

- Zbatohen rregullat e sigurise teknike ne pune.
- Vendosja e tabelave te sigurise dhe shendetit ne pune, si dhe vendosja e shenjave ne pajisjet qe tregojne llojin e rrezikut;
- Instalimi i mjeteve dhe pajisjeve kundra zjarrit;
- Mirembajtja e dokumentacionit ligjor per elemente te sigurise ne pune, kontrollit shendetesor periodik i punonjesve etj.
- Personeli i pajisur me mjetet e mbrojtjes personale (uniform, kepuce, kufje, maska, etj) te personalizuar per cdo front pune;

Aktiviteti “ Prodhimi i produkteve prej plastike“ eshte nje aktivitet me rrezikshmeri te larte te zjarrvenies, megjithate, kompania ka instaluar sisteme hidrant, depozita uji, si dhe eshte pajisur me fikese zjarri me shkume per te evituar zjarrin ose perhapjen e tij ne cdo rast. Hidrantet furnizohen me uje nga tubacione celiku dhe mbulojne teresisht territorin e jashtem dhe te brendshem. Punetoret trajnohen vazhdimisht per rrezikun e shperthimit te zjarrit dhe per shuarjen e tij ne rast rreziku. Eshte hartuar dokumentacioni i domosdoshem per sigurine dhe mbrotjen ndaj zjarrit.

11.KONKLUSIONE

Subjekti THERMO + SWISS sha eshte themeluar dhe organizuar sipas Legjislacionit Shqiptar, me nipt. L51423049P, Durres Xhafzotaj, Pasuria Nr. 14/119, Vol. 23, Faqe 74, Zonë kadastrale 3852.

THERMO + SWISS sha propozon qe te zgjeroje aktivitetin e “Prodhimi i produkteve prej plastike”. Subjekti ka eksperienc tashme disa vjecar dhe ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti.

Per funksionimin e aktivitetit jane marre parasysh:

- Parandalimi i ndikimit te demshem ne mjedisin natyror;
- Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
- Përfshirja e parimeve te tilla si ndotesi paguan;
- Përdorimi i teknikave dhe metodave me te mira per mbrojtjen e mjedisit;
- Përdorimi i teknologjisë më të mirë te disponueshme bazuar në ndikimin minimal, te mjedisit perreth;
- Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit ne vendimmarrje dhe akses i publikut në informacion;
- Nxitja e zhvillimit te qendrueshem;
- Trajtimi i mbetjeve sa me afer vendit te gjenerimit dhe gjetja e perdoruesve te rinje.

Skema e projektit teknik vleresohet nëpermjet elementeve të mëposhtem:

- Natyra (lloji): Një vend që ka identitetin e vet.
- Hapesirat: ushtrimi I aktivitetit ne nje mjedis te caktuar me kushte te pershtatshme per ushtrimin e aktivitetit;

Subjekti ka hartuar nje plan ku ka marre parasysh faktoret e meposhtem:

- Ka identifikuar potencialin ekonomik te zones.
- Ka ndihmuar në krijimin e konsensusit rreth së ardhmes së rajonit dhe identifikimit të prioriteteve.
- Ka rritur vleren e tokes dhe duke krijuar më tepër mundesi investimesh.
- Ka tërhequr investimet e sektorit privat dhe duke identifikuar aspiratat dhe rolet e sektorit privat e atij publik.

Realizimi i ketij aktiviteti do te kontribuboj ne zhvillimin ekonomik te zones duke punesuar punonjes nga zona, pagur taksa vendore, sjell rritjen e biznesit per

Thermo + Swiss Sh.



kontraktore te zones dhe nuk pritet te shkaktoj ndikime te qenesishme ne mjedisin, shendetin dhe sigurise se banoreve te zones.

Ekspert Mjedisi

Gavrosh Zela

Per: A Consultant sh.p.k

Adresa: Durres Xhafzotaj, Pasuria Nr. 14/119,
Vol. 23, Faqe 74, Zonë kadastrale 3852.

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania
email: aconstantal@gmail.com ; web:
aconstantal.com.al Cel: 0696032083